



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 40-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 19. 01. 2021, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Mehmetali Krasniqi, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Fadil Sopa, anëtar
5. Hyra Bytyçi, anëtare
6. Naim Jahiri, anëtar
7. Naim Stullca, anëtar
8. Majlinda Sylejmani, anëtare
9. Ramadush Tasholli, anëtar
10. Arif Miftari, anëtar
11. Fatime Krasniqi, anëtare
12. Xhyzide Rrustemi, anëtare
13. Lulzim Rrustemi, anëtar
14. Ramiz Qeriqi, anëtar
15. Nazmi Krasniqi, anëtar
16. Lumturije Bytyqi, Hasani, anëtare
17. Egzona Bytyqi, anëtare
18. Shkelzen Bislimi, anëtar
19. Albulena Kelmendi, anëtare
20. Alban Salihu, anëtar
21. Afrim Miftari, anëtar
22. Hajdin Bytyqi, anëtar
23. Safete Amerllahu, anëtare
24. Bashkim Budakova, anëtar
25. Ukë Kryeziu, anëtar
26. Ganimete Qeriqi, anëtare
27. Manush Shamolli, anëtar
28. Egzona Fazliu, anëtare
29. Fehmi Rexhepi, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Fauz Xhemajli, Nënkryetar i Komunës
3. Latif Ramadani DBF
4. Merita Bytyqi, DSH
5. Bekim Shabani DEZH

6. Emina Rexhiq DPU
7. Valon Pacolli, DA
8. Anila Reçica, DKRS
9. Nazim Gashi, DE
10. Visar Kozhani, zyrtar i lartë financiar
11. Dhe të tjerë prezent

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit tha së pari ju uroj që të kemi një vit të mbarë dhe të keni shëndet dhe suksese ju dhe familjet tuaja, ndërsa kandidatëve për deputet ju uroj suksese.

Pastaj tha se në mbledhje prezentojnë shumica e anëtarëve të Kuvendit. Rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstrakti nga mbledhja e 39-të e Kuvendit
2. Raporti Janar-Dhjetor i shpenzimeve e të hyrave 2020
3. Propozim Rregullore për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komunës.
4. Propozim vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës 15Nr.320-61046 i datës 28.09.2018.
5. Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit 15Nr.500-48448 i datës 30.07.2019 për miratimin e strategjisë dhe planit të veprimit të Komunës së Lipjanit për kujdes parësor shëndetësor
6. Propozim vendim për pezullimin të vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan për varreza në fshatin Rubofc 15Nr.463-14826 i datës 04.03.2019.
7. Propozim vendim për plotësimin e vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e xhamisë në fshatin Llugaxhi 15Nr.463-20391 i datës 29. 03. 2019
8. Propozim vendim paraparak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës.
9. Propozim vendim për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës në ZK Lipjan.
10. Propozim vendim për zëvendësimin e anëtarit të Komitetit për Komunitete.
11. Propozim vendim për zëvendësimin e anëtarit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB-së
12. Propozim vendim mbi obligimet e pa kryera financiare nga viti paraparak 2020

Ndërsa pika sa i përket informatës rreth drejtoratit të Shëndetësisë mbetet për muajin shkurt.

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit pyeti se a ka vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës.

Latif Ramadani, tha se kemi një propozim shtesë që të futet në rend të ditës edhe një pike e cila është propozim vendim mbi obligimet e pa kryera financiare nga viti paraparak 2020

Pastaj Kryesuesi pyeti anëtarët e Kuvendit se a ka dikush vërejtje rreth rendit të ditës së propozuar.

Pastaj u kalua në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Meqë vërejtje nuk pati Kryesuesi vuri në votim rendin e ditës së propozuar dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 26 vota për, aprovoi rendin e ditës.

Pastaj u vazhdua me pyetjet e anëtarëve të Kuvendit.

Egzona Bytyqi, së pari ju uroj vit të mbarë të gjithëve po ashtu edhe drejtorit të ri i uroj suksese në detyrën e tij.

Çështja e parë e cila do ta ngris ka të bëjë në vërshimet e fundit në Komunën tonë ku deshta të informohem se si ka qenë plani i komunës dhe a është bërë vlerësimi i dëmeve. A ka buxhet komuna që të ju dal në ndihmë të prekurve nga vërshimet.

Çështja e dytë kam një kërkesë që të bëhet një aparat për matjen e indeksit të cilësisë së ajrit siç e ka edhe komuna e Prishtinës, si preventiv e shumë sëmundjeve.

Ramiz Qeriqi, edhe unë ju uroj vit të mbarë dhe suksese të gjithëve po ashtu ngushllime për ata që kanë humbur familjarët e tyre, ngushllime edhe Kryetarit për vdekjen e prindit.

Kam dy kërkesa; e para ka të bëjë me barnatoret e të cilat nuk po punojnë sa duhet dhe çmimet po janë të ndryshme prej barnatores në barnatore. Ndërsa kërkesa e dytë ka të bëjë me çmimet në markete ku tjera çmime janë te raftet, ndërsa kur e bën pagesën del çmim tjetër.

Lulzim Rustemi, edhe unë ju uroj vit të mbarë dhe suksese të gjithëve po ashtu drejtorit punë të mbarë në detyrën e re. Kam një kërkesë apo sygjërim për Drejtoratin e Shërbimeve Publike që të zgjerohet dhe të thellohet Lumi Janjevka pasi që nëse do të ketë vërshime prap do të shkaktoj probleme.

Ukë Kryeziu, edhe unë ju uroj suksese kandidatëve për deputet po ashtu të gjithëve tjerëve ju uroj punë të mbarë dhe vit të mbarë.

Vërshimet kanë qenë një problem i madh edhe për komunën tonë, kërkoj nga Drejtorati për Shërbime Publike që të bëjë një komision dhe të shikoj dëmtimet që janë bërë në Lumin e fshatit Sllovi ku është dëmtuar 70% dhe është mirë që ky komision ta njoftoj Ministrinë e linjes lidhur me atë lum. Kërkoj që të bëhet pastrimi i lumit në Sllovi.

Lumturije Bytyqi-Hasani, edhe unë i uroj punë të mbarë drejtorit të ri. Kam dy kërkesa; e para ka të bëjë me rrugën Zylfije Gashi ku trotuari është i dëmtuar dhe kompania nuk e ka kthyer në gjendjen e mëparshme. Nuk e dijë a është inspektu nga komuna ndonjëherë.

Edhe çështja e dytë ka të bëjë me të njejtën rrugë në të cilën është jashtë funksionit ndriçimi publik.

Albulena Kelmendi, ajo që mua më preokupon është se dje ka filluar viti shkollor por nuk e dijë sa janë bërë përgatitjet rreth fillimit të mësimit lidhur me dezinfektuesit, nxemjes e përgatitje tjera. Kam një rekomandim për DKA-në që me fillu me u zgjatë orët mësimore pasi që sipas Ministrisë tani lejohet të tubohen deri në 30 persona dhe është mirë që të fillohet të punohet në orar të rregullt.

Xhyzide Rustemi, ndjej keqardhje për dëmet e shkaktuara nga vërshimet te disa bizneseve dhe ekonomive familjare edhe pse ekzekutivi ka punuar rreth pastrimit të lumenjëve. Kam një kërkesë të banorëve të fshatit Banullë që të vendoset mbishkrimi me emrin e fshatit pasi që ai mungon.

Imri Ahmeti, edhe unë ju uroj të gjithëve vit të mbarë ndërsa kandidatëve për deputet ju uroj suksese. Në Lipjan nuk e kemi pritë që vërshimet do të na shkaktojnë kaq shumë telashe edhe pse kemi pastruar disa lumenjë, procka etj.

Ne kemi formuar ekipet emërgjente të cilat janë në teren ku një ekip e veçantë është për verifikimin e ekonomive familjare, ndërsa një komision tjetër për rrugët infrastrukturore.

Shtrati i lumit në Sllovi është i demoluar dhe sipas ekspertëve tonë dëmet janë shumë të mëdha. Ende nuk i kemi evidentuar të gjitha dëmet por jemi në proces. Pajtohem me doktoreshen që të ketë një aparat për matjen e ajrit në Lipjan. Sa i përket çmimit në markete dhe barnatore do t'i shtojmë masat. Ndërsa sa i përket lumit Janjevka komisioni është duke e bërë evidentimin e dëmeve po ashtu kemi një komision së bashku me komunën e Graçanicës i cili do të dal në rrugën kryesore dhe të shikoj situatën për hapjen e kanaleve për rreth rrugës nga bizneset. Sa i përket vërshimeve në Banullë është pastruar Lumi por duhet të vazhdojë të pastrohet deri në Glllogovc.

Rruga „Zylfije Gashi” aty është rrugë e shtruar më herët por do të shikohet mundësia që në atë rrugë të bëhet ndriçimi publik i ri dhe të asfaltohet. Jam në takord që të filloj mësimi me orar të rregullt dhe ne i kemi bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e mësimi.

Pastaj u kalua me punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I.

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 39-të të Kuvendit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet të cilat i keni marrë.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati Kryesuesi vuri në votim ekstraktin nga mbledhja e 39-të të Kuvendit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për

Aprovoi

Ekstraktit nga mbledhja e 39-të të Kuvendit

Shtesë: Ekstrakti.

II.

Raporti Janar-Dhjetor i shpenzimeve e të hyrave 2020

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Latif Ramadani drejtor i DBF-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Afrim Miftari, e kam shqyrtu dhe e kam analizu këtë raport por kam disa pyetje e para ka të bëjë te gjobat mandatare ku nëse e krahasojmë me vitin e kaluar po dalim negative. Po ashtu çështja e dytë ka të bëjë me mirëmbajtjen dhe investimet në qytet dhe fshatra. Ku në fshatin Gadime ka disa muaj që dritat nuk janë duke punuar dhe për këtë menaxherët gjatë projekteve duhet të jenë më sy qelur dhe t'i përcjellin këto. Edhe unë i uroj drejtorit Valonit për detyrën e re.

Lulzim Rustemi, e kemi analizu këtë raport dhe si duket ky buxhet len shumë për të dëshiruar ku kemi shfrytëzim të dobët të buxhetit dhe mbetje të mjeteve. Ku te investimet kapitale kemi shifër të vogël të shpenzimit te Shërbimet Publike por nuk është më mirë as te drejtoratet tjera. Te granti qeveritar kemi një shumë të madhe e cila është mbi 600 mijë euro e cila ka shkuar suficit. Po ashtu edhe te të hyrat vetanake kemi shpenzim shumë të vogël. Kam një pyetje te derivatet kemi rritje të shpenzimeve. Uroj që mjetet e mbetura të shfrytëzohen ashtu siç duhet.

Ramiz Qeriqi, kam një pyetje pse te këto OJQ-të të cilat po përfitojnë, OJQ YAHR po ka kaq dallim të madh prej OJQ-ve tjera. Dhe pyetja tjetër pse nuk po punohet më shumë në ujësjellës por në ndriçim publik.

Latif Ramadani, kemi një buxhet të shfrytëzuar ashtu siç është real dhe kjo dihet se ka qenë vit ku kemi qenë me pandemi Covid-19.

Te të hyrat të cilat nuk janë shfrytëzu do të barten në vitin vijues. Ndërsa sa i përket gjobave ato vetëm na vijnë nga Gjykata.

Mirëmbajtja e ndriçimit publik është duke u vazhduar. Ndërsa sa i përket rritjes së shpenzimeve të derivateve ato janë rritur për shkak se disa vetura na i ka marrë stacioni policor e me disa tjera shtabi emergjent ka bërë shperndarjen e ndihmave në teren.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati u kalua në pikën në vazhdim

III.

Propozim Rregullore për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim më pak se një vit të pronës së paluajtshme të Komunës.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Bekim Shabani, drejtor i DEZH-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Rregullores.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, kërkoj një sqarim te neni 7 pika 2.3 për cilat lokale është fjala.

Bekim Shabani, ka të bëjë me lokalet të cilat ipen deri në një vit dhe këtë e bënë Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e Rregullores dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 24 vota për aprovoi:

IV.

Propozim vendim për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës 15Nr.320-61046 i datës 28.09.2018.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Emina Rexhiqi, drejtor i DPU-së, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim vendimi.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Lulzim Rrustemi, po shihet se po ndeshemi me investitor jo serioz, ndoshta ky ka mendu me investu por me sa po shihet nuk ka levizur fare rreth kësaj çështje dhe unë nuk jam për me ja vazhdu.

Afrim Miftari, me sa po shihet ky ka pas disa arsye pse nuk ka fillu po ashtu edhe pandemia dhe ne jemi që të kaloj ky propozim vendim.

Albulena Kelmendi, problemin e qenëve endacak unë e kam ngritë disa herë në Kuvend, investitori është vonu por unë mendoj se ma mirë me pas investitorë jo serioz se sa hiq. Dhe unë jam që të kaloj pasi që është në të mirën e qytetarëve.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, tha se toka është pronë privat e tij dhe edhe ne si komunë kemi punu me staf të reduktum për shkak të situatës me pandemi. Është në dobi të qytetarëve nëse bëhet ai investim.

Ramiz Qeriqi, ne po japim leje për qenë endacak por a mund ta shfrytëzoj ky këtë pronë për diçka tjetër.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 21 vota për, një apstenim aprovoi:

VENDIM

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË TOKËS 15NR.320-61046 I DATËS 28.09.2018

Neni 1

Me këtë Vendim, ndryshohet dhe plotësohet neni 5 i Vendimit për ndërrimin e destinimit të tokës 15Nr.320-61046 i datës 28.09.2018 dhe riformulohet si vijon:

“Obligohet investitori që obligimet që rrjedhin për implementimin e Projektit të tij konform dispozitave të Vendimit të Kuvendit të Komunës për ndërrimin e destinimit të tokës ti kryej më së largu me datë 31.12.2021 “.

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrotjtje të Mjedisit, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë:Vendimi.

V.

Propozim vendim për shfuqizimin e vendimit 15Nr.500-48448 i datës 30.07.2019 për miratimin e strategjisë dhe planit të veprimit të Komunës së Lipjanit për kujdes parësor shëndetësor

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Merita Bytyqi, drejtoreshë e DSHMS-së, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 21 vota për, një apstenim aprovoi:

VENDIM

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT 15NR.500-48448 I DATËS 30.07.2019 PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË DHE PLANIT TË VEPRIMIT TË KOMUNËS SË LIPJANIT PËR KUJDES PARËSOR SHËNDETËSOR

Neni 1

1. SHFUQIZOHET, Vendimi 15Nr.500-48448 për miratimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit të Komunës së Lipjanit për kujdes parësor shëndetësor i datës 19.07.2019 si dhe Strategjia dhe Plani i veprimit i Komunës së Lipjanit për Kujdes Parësor Shëndetësor (2020-2024) si pjesë përbërëse e Vendimit .

Neni 2

OBLIGOHET, Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale të zhvillojë paraprakisht konsultimet e nevojshme me Ministrinë e Shëndetësisë rreth procedurës së nxjerrjes dhe miratimit të dokumenteve strategjike të komunës për kujdes parësor shëndetësor në përputhje me politikat nacionale për KPSH.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të përkujdeset Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë: Vendimi.

VI.

Propozim vendim për pezullimin të vendimit për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan për varreza në fshatin Rubofc 15Nr.463-14826 i datës 04.03.2019.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Anila Reçica, drejtoreshë e DKRS-së, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Bashkim Budakova, sa i përket këtij propozim vendimi për varrezat në fshatin Rubovc po kërkohet që ky propozim vendim të pezullohet deri në përfundimin e procedurës gjyqësore. A i bie kjo që banorët e fshatit Rubovc të presin 4 deri në 14 vite pasi që vendimet gjyqësore zgjatin kaq kohë. Edhe ashtu banorët e fshatit Rubovc nga paraqitja e kërkesës kanë pritur mbi 2 vite.

Pyetja ime për ekzekutivin është cila është zgjidhja që duhet të ju bëhet banorëve të fshatit Rubovc kur dihet që nevojat janë imediate qysh tani.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, Komuna prej se jam unë këtu edhe kur nuk kam qenë unë çdo herë ju ka përgjigjë kërkesave të qytetarëve për varreza dhe asnjëherë nuk i ka refuzuar. Dhe këtu nuk është faji i komunës pasi që një qytetarë ka ngritur padi në gjykatë dhe kush do ka të drejtë të bëjë ankesë për të drejtën e vetë.

Është e pa drejtë të kritikohet ekzekutivi pasi që ne e kemi prurë kërkesën në Kuvend dhe Kuvendi e ka votuar, mirëpo tani ajo lëndë është në gjykatë. Dhe unë kërkeoj që të përkrahet ky propozim vendim pasi që jemi të obliguar dhe nëse nuk kalohet po humbim grante e me këtë po humbin edhe qytetarët.

Ukë Kryeziu, deri sa Ministria kërkon ta pezullojmë këtë vendim ne duhet të veprojmë. Por unë dola që ta ngris një shqetësim timin për disa vendime të cilat ne po i marrim e që po kërkohet që Bashkësive fetare të ju dhurohet prona për varreza. Unë ju lus që Bashkësitë fetare mos t'i paisim me prona publike por vetëm të ju bëhet ndërrimi i destinimit dhe prona të jetë e komunës.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha se parafolësi ka të drejtë plotësisht dhe to t'i shohim propozimet e ardhshme në harmonizim me ligjet në fuqi.

Ramiz Qeriqi, edhe unë pajtohem me Ukën pasi që sot po na i kërkojnë pronat për Xhamia nesër kush e din për çka i kërkojnë.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, edhe unë pajtohem që pronësia të jetë e komunës vetëm të ndërrohet destinimi por në rast se kemi kërkesa të tilla do të veprohet kështu.

Lulzim Rrustemi, është mirë që banorëve të fshatit Rubovc të ju bëhet një zgjidhje sa i përket varrezave. Po ashtu është mirë që Kryesuesi të i bije në Kuvend vendimet të cilat i bjen Ministria dhe ne si Kuvend t'i diskutojmë.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha se për secilin nga këto vendime të cilat na kanë ardhur kemi bërë shkresë në Ministri dhe për asnjërin nga këto nuk kemi marrë përgjigje. Padrejtësisht na u ka bërë kjo por ne për interes të qytetarëve në mënyrë që mos ta humbim grantin duhet ta votojmë.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 23 vota për, 2 apstenime aprovoi:

VENDIM

PËR PEZULLIMIN TË VENDIMIT PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS KOMUNALE KËSHILLIT TË BASHKËSISË ISLAME NË LIPJAN PËR VARREZA NË FSHATIN RUBOFC 15NR.463-14826 I DATËS 04.03.2019

I. PEZULLOHET, Vendimi i Kuvendit të Komunës për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale Këshillit të Bashkësisë Islame në Lipjan për Varreza në fshatin Rubofc 15Nr.463-14826 i datës 04.03.2019 .

II. Vendimi i cekur pezullohet deri në përfundimin e procedurës gjyqësore të inicuar nga pala paditëse përkitazi me pronën komunale të dhënë në shfrytëzim sipas Vendimit të cekur në pikën i të këtij Vendimi .

III. Pas përfundimit të arsyeve që kanë shkaktuar pezullimin e zbatimit të Vendimit i njëjti do të miratohet në njërën nga seancat e ardhëshme të Kuvendit të Komunës i harmonizuar edhe me rekomandimet e cekura në Shkresën përcjellëse të MAPL-së dhe legjislacionin në fuqi .

IV. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit të Komunës-Sektori Pronësor Juridik , Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.

V. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës

Shtesë: Vendimi.

VII.

Propozim vendim për plotësimin e vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Xhamisë në fshatin Llugaxhi 15Nr.463-20391 i datës 29. 03. 2019

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Anila Reçica, drejtoreshë e DKRS-së, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lumturije Bytyqi-Hasani, nëse propozim vendimi është gabim atëherë edhe udhëzimi i ministrisë është gabim dhe fjala preambulë përdoret në Kushtetutë konventa apo edhe në marrëveshje por nuk mund të përdoret siç është këtu. Unë po kërkoj që të hiqet fjala preambulë dhe të jetë vetëm pjesa hyrëse.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, MAPL-ja e ka një Rregullore me të cilën miratohen aktet e komunave. Preambula apo pjesa hyrëse përdoret në të gjitha aktet. Ne jemi të obliguar që t'i respektojmë vendimet e Ministrisë.

Lumturije Bytyqi-Hasani, preambula është më shumë deklaratë solemne dhe nuk pajtohem që është sinonim i fjalës hyrëse.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, unë jam i detyruar që t'i respektoj vendimet e nivelit qëndror.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 26 vota për, aprovoi

VENDIM

PËR PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E XHAMISË NË FSHATIN LLUGAXHI 15NR.463-20391 I DATËS 29.03.2019

Neni 1

Me këtë Vendim plotësohet pjesa e hyrëse - preambula e Vendimit të Kuvendit të Komunës për caktimin e lokacionit për ndërtimin e xhamisë në fshatin Llugaxhi 15Nr.463-20391 i datës 29.03.2019 edhe me një dispozitë të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor ashtu që :

Te dispozitat e numëruara të Ligjit Nr.04/L-174 për Planifikim Hapësinor në preambulën e Vendimit pas neneve të numëruara 5 par.1.2 dhe 10 shtohet edhe neni 26 paragrafi 7 i

Neni 2

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Zyra e Kryetarit-Sektori pronëso-ro-juridik, Drejtorati, Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër

Neni 3

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Shtesë: Vendimi.

VIII.

Propozim vendim paraparak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Bekim Shabani, drejtor i DEZH-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 27 vota për, aprovoi

VENDIM

PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Neni 1

Me këtë Vendim u ipen në shfrytëzim afatshkurtër personave fizik dhe juridik paluejtshmëritë-lokalet afariste në pronësi të komunës, të cilat gjenden në qytetin e Lipjanit - Zona kadastrale në Lipjan, me shënimet si në tabelën në vijim:

Nr	Njësia kadastrale	Adresa	Kati	Numri i lokalit	Sipërfaqja në m ²
1	0-71409044-01926-0-29-1-17-0	Rruga "Lidhja e Prizrenit" 29P+5 1 17	Bodrum	6	89.46m ²
2	0-7140944-0024-5-14-0	Rruga "Lidhja e Prizrenit" 24 P 513	Përdhe së	15	159 m ²
3.	0-7140944-0024-5-B1-0	Rruga "Lidhja e Prizrenit" 24 B 5I	Bodrum		239 m ²

Neni 2

Pronat e paluajtshme –lokalet të cekura në pjesën tabelare në nenin 1 të këtij Vendimi ipen në shfrytëzim, afatshkurtër në afat prej 10 vitesh nëpërmjet procedurave të ankandit publik të përcaktuar me dispozitat e të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe të Rregullores QRK Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 3

Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronave të paluajtshme-lokaleve në pronësi të Komunës të cekura më lartë bëhet me qëllim të realizimit të interesit publik përkatësisht krijimin e të hyrave vetanake dhe rritjen e vlerës së pronës publike komunale me destinim për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme të biznesit .

Neni 4

Procedurën e ankandit publik e zbaton Komisioni Vlerësues në pajtim me dispozitat e Rregullores QRK Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës .

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit-sektori pronëso-ri-juridik, Drejtorati për Ekonomi e Zhvillim dhe Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër.

Neni 6

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Neni 7

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi

1. Shfuqizohet Vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës 15Nr.463-20393 i datës 29.03.2019,
2. Te Vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës 15Nr.463-28074 i datës 02.05.2018 në nenin 1 hiqet-fshihet lokali në numrin rendor 3 ,
3. Te Vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës 15Nr.463-6525 i datës 01.02.2018 në nenin 1 -fshihet paragrafi 1.3.
4. Anulohet Vendimi paraprak 15Nr.463-60371 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme i miratuar me datë 14.12.2020

Shtesë: Vendimi.

IX.

Propozim vendim për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës në ZK Lipjan.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Bekim Shabani, drejtor i DEZH-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Ramiz Qeriqi, pse gjithmonë në komision është ky Denis Gashi?

Bekim Shabani, gjatë aplikimit të OJQ-ve kanë aplikuar Denis Gashi dhe Gentrin Zogaj mirëpo për shkak se Gentrin Zogaj nuk po vjen edhe pse disa herë e kemi ftuar ne për shkak të mos ngecjes së punës po e qesim Denis Gashin.

Nehat Tërpeza, në emër të grupit të LDK-së e propozojmë Majlinda Sylejmanin.

Egzona Bytyqi, në emër të grupit të PDK-së e propozojmë Nazmi Krasniqin.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, tha se komisioni ka këtë përbërje.

Bekim Shabani, nga ekzekutivi i komunës

Nazim Gashi, nga ekzekutivi i komunës

Majlinda Sylejmani, nga subjektet politike

Nazmi Krasniqi, nga subjektet politike
Denis Gashi, nga OJQ-të.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 26 vota për, aprovoi

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE PËR
DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATSHKURTËR TË PRONAVE TË PALUAJTSHME TË
KOMUNËS NË ZK LIPJAN

Neni 1
Përbërja e Komisionit

1. Formohet Komisioni vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronave së paluajtshme të komunës– lokaleve afariste për Vendimin paraprak për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës 15Nr. _____ i datës _____ (në vazhdim të tekstit: Komisioni në përbërje prej 5 (pesë) anëtarëve, prej të cilëve 2 (dy) anëtarë të propozuar nga Kryetari i Komunës nga përbërja e ekzekutivit të Komunës, 2 (dy) anëtarë nga Kuvendi i Komunës nga subjektet politike dhe 1 (një) anëtar nga sektori jo qeveritar lokal.

2. Anëtarë të Komisionit emërohen, si vijon :

1. Bekim Shabani, Drejtor i Drejtoratit për Ekonomi dhe Zhvillim nga ekzekutivi i Komunës
2. Nazim Gashi, Drejtor i Drejtoratit për Mbrojtje dhe Shpëtim nga ekzekutivi i Komunës
3. Majlinda Sylejmani, nga subjektet politike
4. Nazmi Krasniqi, nga subjektet politike
5. Denis Gashi nga sektori joqeveritar lokal

Neni 2
Zgjedhja e Kryesuesit

Anëtarët e Komisionit me shumicë të votave, e zgjedhin Kryesuesin e Komisionit i cili e kryeson punën e Komisionit.

Neni 3
Mandati i anëtarëve

Mandati i anëtarëve të Komisionit është i përkohshëm dhe caktohet për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për Vendimin paraprak për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës _____ të datës _____ .

Neni 4
Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisionit

Komisioni, për të zbatuar Vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës të cekur më lartë me të cilin është vendos për pronën e cila do jepet në shfrytëzim, është përgjegjës për zbatimin e procedurave të parapara me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-092 për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës dhe Rregullores QRK Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 5
Punët administrative - juridike të Komisionit

Komisionit në realizimin e detyrave të përcaktuara me Ligj me akte nëligjore dhe me këtë vendim do ti ndihmojnë në kuadër të kompetencave të tyre Zyra Kryetarit të Komunës – Sektori pronësor-juridik.

Neni 6

Kompenzimi i punës së Komisionit

Anëtarët e Komisionit për punën e tyre për zbatimin e procedurave të vlerësimit të ofertave të një Njoftimi publik do të kompenzohen në lartësinë e një kompenzimi, i cili u paguhet për pjesëmarrje në mbledhje anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa. Kompenzimi do të bëhet vetëm për anëtarët e komisionit të cilët nuk e kanë të ndaluar kompenzimin për kryerjen e shërbimeve shtesë konform dispozitave të Ligjit për Menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe akteve tjera nënligjore me të cilat rregullohet kjo çështje nëse të njëjtat nuk bien në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi anulohet Vendimi 15Nr.463-60377 për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës në ZK Lipjan i miratuar me datë 14.12.2020.

Shtesë: Vendimi.

X.

Propozim vendim për zëvendësimin e anëtarit të Komitetit për Komunitete.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 26 vota për, aprovoi

V E N D I M

PËR ZËVENDËSIMIN E ANËTARIT TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE

Neni 1

Zëvendësimi i anëtarit të Komitetit për Komunitete

Me këtë Vendim, zëvendësohet ish-anëtari i komitetit për komunitetete z. Ferat Gashi nga komuniteti rom për shkak të vdekjes i caktuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës për themelimin e Komitetit për Komunitete 15Nr.020-67918 të datës 22.12.2017, në numrin rendor 5 dhe në vend të tij ÇAKTOHET Znj. Nadije Gasi nga Janjeva poashtu nga komuniteti rom konform kërkesës së parashtruar nga Komuniteti rom 1-020-63480 të datës 30.12.2020.

Neni 2

Detyrat, përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi

Detyrat , përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi i anëtarëve të Komitetit për Komunitete janë të përcaktuara me dispozitat e neneve 51 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, neneve 33 dhe 35 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008, Udhëzimit administrativ nr.03/2014 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komuniteteve të përhershme në Komunë , Vendimit të Kuvendit të Komunës për themelimin e Komitetit për Komunitete 15Nr.020-67918 të datës 22.12.2017 si dhe Udhëzimit administrativ (MAPL) Nr.02/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e

Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.03/2014 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komuniteteve të përhershme në Komunë Nr.0-1498 të datës 31.12.2018.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas e publikimit në WebFaqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

XI.

Propozim vendim për zëvendësimin e anëtarit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi-KKSB-së

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Nazim Gashi, drejtor i DMSH-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 26 vota për, aprovoi

V E N D I M
PËR ZËVENDËSIMIN E ANËTARIT TË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI –KKSB-së

Neni 1
Zëvendësimi i anëtarit të KKSB-së

Me këtë Vendim, **zëvendësohet** anëtari i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi Z. Srđan Stankovič nga kisha ortodokse, në numrin rendor 4 të nenit 1 të Vendimit të Kuvendit të Komunës për Themelimin e KKSB në Komunën e Lipjanit 15Nr.020-67926 të datës 22.12.2017dhe në vend të tij **caktohet** Z. Dragiša Jerinič , prift i kishës ortodokse në Lipjan në pajtim me shkresën - njoftimin 1Nr.020-58842 të datës 03.12.2020.

Neni 2
Detyrat, përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi

Detyrat, përgjegjësitë, mandati dhe kompensimi i anëtarëve të KKSB-në është i përcaktuar me dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB- 03/2012 për Këshillat Komunale për siguri në bashkësi dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës për Themelimin e KKSB në Komunën e Lipjanit 15Nr.020-67926 të datës 22.12.2017.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në WebFaqen e Komunës.

Shtesë: Vendimi.

XII.

Propozim vendim mbi obligimet e pa kryera financiare nga viti paraparak 2020

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Latif Ramadani, drejtor i DBF-së, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?
Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 26 vota për, aprovoi

VENDIM
MBI OBLIGIMET E PA KRYERA FINANCIARE NGA VITI PARAPRAK 2020

Neni 1.

Me këtë Vendim bëhet ndryshimi i ndarjeve buxhetore në projekte kapitale në shumë prej.....79,123.00€

Neni 2.

Mjetet nga ky projekt në Investime Kapitale (fondi burimor 10) prej këtij Programi :

-Infrastruktura Publike-Programi 18163 "Vazhdimi i ndërtimit të sheshit "Adem Jashari " pjesa II (kodi i projektit 49399) në shumë

prej.....79,123.00€

Mjetet nga ky projekt bartet në keto projekte:

Infrastrukturë Publike(180)-Programi(18163) kodi funksional 0451:

"Ndriqimi publik në Mdevec dhe Vrellë të Magures (kodi i projektit 49362) në shumë

prej..... 16,054.00€

"Ndertimi i rrjetit te ndriqimit publik përgjatë rrugës Lipjan Magure (kodi i projektit 49136) në shumë

prej6,650.00€

"Vazhdimi i ndertimit te shtratit te lumit ne Dobraje e Madhe (kodi i projektit 42144) në shumë

prej.....22,350.00€

„Rekonstruimi i ndriqimit publik ne qytetin e Lipjanit (kodi i projektit 42143) në shumë

prej.....7,396.00€

„Asfaltimi i rrugicave ne Resinovec (kodi i projektit 49366) në shumë prej.....7,016.00€

Totali..... 59,466.00€

Shërbime Rezidenciale (755)- Programi (75512) kodi funksional 1080:

"Anex objekt për aktivitete në shtëpinë me bazë në komunitet (kodi i projekti 47843) në shumë

prej..... **19,657.00€**

Neni 3.

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Buxhet dhe Financa

Neni 4.

Ky Vendim hyn në fuqi 7 dite pas publikimit ne faqen elektronike të Komunës.

Neni 5.

Me këtë Vendim të njoftohet Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe MF-Prishtinë ndërsa një kopje ruhet në materialin e Kuvendit.

Shtesë: Vendimi.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbleldhja përfundoi në ora 12,⁴⁵

Ekstraktin e hartoi
Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi